



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 154, Datë 13.06.2022

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ALBESP TRADING &
CONSULTING” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021 si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 910 prot., datë 10.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie autorizimit ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 02.12.2021.
- Me shkresën nr. 16 prot., datë 09.02.2022, protokolluar në ERE me nr. 257 prot., datë 11.02.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 95, datë 09.05.2022, ka vendosur:
- Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacion plotësues në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributit financiar të tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 257/5 prot., datë 24.05.2022 dhe brenda afatit të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 95/2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 257/6 prot., datë 09.06.2022. Sa më sipër, duke iu referuar edhe deklaratës së shoqërisë, se ajo konsideron zëvendësimin e aksionerit si një vlerë e shtuar për të çuar

përpara biznesin e saj, me qëllim mbarëvajtjen e shoqërisë në vijim, vlerësohet se dokumenti i përcjellë nga shoqëria është i plotësuar tërësisht.

- Nga analiza përfundimtare që iu dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
 - - Paraqitja e kërkesës - neni 5, pika 2, 4 dhe 5.
 - - Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE - neni 7, pika 1, gërmat a), b), c), d), e), f), g), pika 2, gërmat a), b), c), ç), d), e), f).
 - Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
 - Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të transferimit të kuotave.
 - Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k..
2. Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI